

PROCES VERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Projekt i detajuar teknik “Linja hekurudhore Porti Porto Romano -Sukth”

Projekte 22114311-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 23.682.375 (njëzet e tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) Lekë pa tvsh./ 243.345,41 (dyqind e dyzet e tre mijë e treqind e dyzet e pesë presje dyzet e një) . euro pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 (ndryshuar me ligjin nr.16/2024, datë 08.02.2024) “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024) autoriteti/enti kontraktor ”**Autoriteti Portual Durrës**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1.1 Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 79, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros të realizuara nga operatori ekonomik për 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se dyfishi i vlerës të parashikuar të fondit limit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është e bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin, 43 pika 2 gërma a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021(ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024) “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

1.Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë jo më pak se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 2,3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.LICENCA DHE CERTIFIKIME PROFESIONALE TË KOMPANIVE PROJEKTUESE DHE STAFIT

Subjektet Projektuese, pjesmarrëse kërkohen të zotërojnë, Liçensa në Projektim, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 943, datë 28.12.2016, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për liçensimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

Për ofertuesit e huaj, në zbatim të dispozitave ligjore më sipër, duhet të kenë të ekuivalentuar licensën sipas licensimit të Legjislacionit Shqiptar.

1. PROJEKTIM URBANIST c- Plane të detajuara vendore

Argumentim:

Duke u bazuar në:

- VKM Nr. 943, datë 28.12.2016, “Për miratimin e listës së profesioneve, kriterëve dhe procedurave për pajisjen me certifikatë profesionale dhe licencë në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit”;
- Ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar me Ligjin Nr. 119/2020;
- Kërkesat e ToR dhe specifikimeve teknike të projektit “Linja Hekurudhore Porto Romano – Sukth”,

kërkohet që subjekti projektues të jetë i pajisur me licencën “Projektim Urbanist – C: Plane të Detajuara Vendore”, për realizimin e komponentit të integritetit të infrastrukturës hekurudhore me zhvillimin urban të zonës së ndërtimit.

Kjo kërkesë është e domosdoshme për arsyet:

1. Zhvillimi i projektit ndërhyr në një territor të paplanifikuar më parë, me ndikime të qarta në strukturën urbane, aksesin rrugor dhe përdorimin e tokës.
2. Nevoja për përgatitjen e një Plani të Detajuar Vendor (PDV) për integrimin e linjës hekurudhore dhe stacionit me:
 - Zhvillimet ekzistuese industriale, portuale dhe logjistike në Porto Romano;
 - Planin e miratuar të “Durana Tech Park”;
 - Rrjetin rrugor lokal dhe sistemin e pronësisë.

3. Ligjërisht, hartimi i një PDV mund të kryhet vetëm nga subjekte të licencuara në kategorinë “Projektim Urbanist – C”, të regjistruar pranë Ministrisë përgjegjëse për territorin.

Në mungesë të kësaj licence, nuk do të mund të hartohet dhe miratohet plani rregullues dhe zhvillimor i zonës, çka do të bllokonte miratimin e lejes zhvillimore dhe ndërtimore për projektin.

2. PROJEKTUES ARKITEKT

- a- **Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.**
- b- **b-1. objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara; 2. qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore; 3. objekte spitalore; terminalët në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.**

Argumentim:

Ky projekt përfshin:

- Projektimin e një terminali hekurudhor mallrash, me stacion të dedikuar për manovrim trenash, magazinim dhe shërbime logjistike
 - Godinë teknike funksionale për stacionin hekurudhor, që përfshin hapësira për personel, komanda, sinjalizim, shërbime sanitare dhe ndriçim
 - Struktura ndihmëse me funksion industrial-infrastrukturor, të cilat janë pjesë përbërëse e gjurmës urbane dhe arkitektonike të projektit
 - Ndërhyrje në infrastrukturë të nivelit kombëtar, për të cilat kërkohet detyrimisht zgjidhje arkitektonike për ndërfaqen me territorin dhe funksionalitetin njerëzor
1. Sipas VKM Nr. 943/2016, projektimi i çdo strukture me funksion përdorimi njerëzor dhe/ose ndërtim të integruar me infrastrukturën, kërkon arkitekt të licencuar në kategoritë përkatëse.
 2. Stacioni hekurudhor dhe terminali janë të përfshirë te “b.3: terminale në infrastrukturë” dhe “objekte industriale” (a), që janë në listën e veprave për të cilat kërkohet arkitekt i licencuar.
 3. Objektet ndihmëse teknike dhe ambientet e shërbimit (për personel, mirëmbajtje, siguri, etj.) përbëjnë objekte ndërtimore që duhet të projektohen dhe firmosen nga një arkitekt me përvojë dhe licencë profesionale.
 4. Funksioni social dhe intermodal i projektit kërkon trajtim arkitektonik jo vetëm për funksionin teknik, por edhe për përputhjen me mjedisin urban, sigurinë, ergonominë dhe standardet e përdorueshmërisë.

Përfshirja e një profesionisti me licencën “Projektues Arkitekt” në kategoritë a dhe b (1–3) është detyrim ligjor dhe teknik për projektimin dhe realizimin e:

- Stacionit hekurudhor
- Strukturave mbështetëse funksionale
- Terminalit mallrash dhe ndërlidhjes me territorin
- Objekteve të lidhura me veprën infrastrukturore hekurudhore

Në mungesë të kësaj licence, dokumentacioni i projektimit nuk mund të pranohet për miratim zhvillimor dhe ndërtimor.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a- **Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.**

c-2 **Troje dhe shpate dhe shpate me qendrueshmëri të ulët.**

d. **Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.**

Argumentim:

Projekti përfshin një sërë ndërtimesh dhe analizash strukturore që kërkojnë **ekspertizë të thellë konstruktive**, si:

1. Objekte ndihmëse mbi tokë:

- Stacione, kabina teknike, godina të vogla teknologjike ose administrative – zakonisht objekte 1–3 kate, të ndërtuara me strukturë beton-arme ose metalike → **kërkon licencën “a”**

2. Veprat inxhinierike në shtrirje lineare:

- Mure mbajtës përgjatë shpatit
- Ura ose struktura mbështetëse të linjës hekurudhore
- Zgjidhje për shpate me rrezik rrëshqitjeje ose çedimi → **kërkon licencën “c-2”**

3. Objekte ekzistuese për përforcim / rikonceptim:

- Në rast të **rindërtimit ose rikualifikimit të një segmenti të linjës ekzistuese** ose objekteve ekzistuese teknike → nevojitet **vlerësim kapaciteti mbajtës dhe përforcim**, sipas **pikës “d”** të licencës

Projektim struktural për objekte ndërtimi - Ligjërisht, çdo objekt teknik, magazinë, stacion apo kabinë kërkon zgjidhje konstruktive të firmosur nga një inxhinier i licencuar

Ndërhyrje në shpate dhe troje me qëndrueshmëri të ulët - Linja kalon në segmente me rrezik gjeoteknik që kërkojnë analizë stabiliteti dhe zgjidhje mbrojtëse

Vlerësim për struktura ekzistuese - Segmentet e lidhura me linjën hekurudhore ekzistuese dhe terminalin e Porto Romanos kërkojnë vlerësim strukturor dhe përf forcime

Përfshirja e një inxhinieri të licencuar si **Projektues Konstruktor** në kategoritë **a, c-2 dhe d**, është **e domosdoshme ligjërish dhe profesionalisht**, për të garantuar:

- Sigurinë strukturore të objekteve
- Qëndrueshmërinë e terrenit dhe ndërhyrjeve inxhinierike në shpat
- Zbatimin e **Eurokodeve të ndërtimit dhe standardeve shqiptare të projektimit**

4. PROJEKTUES INSTALATOR

b. Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.

Argumentim:

- Në godinat teknike të stacionit/trajtimin hekurudhor nevojiten sisteme për **ngrohje, ftohje, ajrosje dhe për prodhim të energjisë termike**, sidomos nëse kërkojnë zgjidhje **efikase dhe me teknologji të gjelbër**.
- VKM 943 e parashikon këtë aktivitet si të **kufizuar**, që mund të realizohet vetëm nga një **instalator i licencuar për b**.

c. Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

Argumentim:

- Projekti përfshin ndërtesa teknike, ndriçim stacionesh dhe magazinash, si dhe lidhje me rrjetin kombëtar → **kërkon projektim të plotë elektrik të brendshëm dhe të jashtëm industrial**.
- Veprimtari e **rregulluar dhe e licencuar**, kërkohe për zbatim të **standardeve të sigurisë elektrike, tensioneve, mbrojtjeve dhe dimensionimeve**.

d. Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit.

Argumentim:

- Stacioni dhe terminali logjistik do të përfshijë **sisteme të brendshme sinjalizimi, transmetimi të dhënash, kontrolli treni dhe rrjete optike/ethernet për komunikim operacional**.
- Përveç aspektit të sigurisë, sistemi i kontrollit kërkon të jetë projektuar nga profesionist i **licencuar në “d”**, për të përmbushur standardet CE dhe EN për infrastrukturë kritike.

f. Projektim të sistemeve kundra zjarrit.

Argumentim:

- Projektimi i sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, **detektorë, sprinkler, pompa zjarrfikëse, rrjete uji dhe gazesh inertë**, është detyrim ligjor për çdo objekt publik, logjistik apo teknologjik.
- Sipas VKM 943 dhe akteve për mbrojtje nga zjarri, **projekti teknik për sistemin kundra zjarrit kërkon instalator të licencuar në “f”**.

g. Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.

Argumentim:

- Stacioni dhe terminali kërkon **sisteme automatike të sinjalizimit hekurudhor, menaxhim energjie, telekomandë për rrjetet elektrike dhe ndriçim** → element kyç për funksionimin e ndërtesës inteligjente dhe të kontrolluar.
- Kërkon projektim të **automateve industriale dhe protokolleve të kontrollit (p.sh. SCADA)** nga projektues i licencuar në “g”.

i. Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.

Argumentim:

- Rruga hyrëse, shinat, sheshet e ngarkim-shkarkimit dhe perimetri i terminalit hekurudhor duhet të **ndriçohen sipas standardeve të ndriçimit publik dhe të sigurisë** (për hekurudhë, rrugë dhe logjistikë).
- Kërkohet projektues me **eksperiencë dhe licencë për ndriçim profesional**, në zonë infrastrukturore të ndjeshme → licenca “i”.

j. Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industrial.

Argumentim:

- Në terminal dhe stacion nevojiten rrjete të integruara për:
 - **CCTV dhe siguri**
 - **Access Control**
 - **Sisteme alarmi dhe dedektimi zjarri**
 - **TV industrial / sinjalizim akustik dhe vizual**
- Rregullohet me licencën “j” dhe është pjesë e **infrastrukturës kritike** për funksionimin dhe mbrojtjen e jetës në ambientet teknike.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

b. Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.

Argumentim:

- Projekti përfshin ndërtimin e strukturave teknike dhe logjistike (stacione hekurudhore, terminal mallrash), të cilat kërkojnë **furnizim të dedikuar me ujë** (ujë sanitar, teknik, zjarrfikës) dhe rrjet të **evakuimit të ujërave të ndotura dhe të shiut**, përmes **kolektorëve shkarkues**.
- Projektimi i këtyre veprave konsiderohet pjesë e **rrjeteve inxhinierike urbane**, dhe kërkon **projektues të licencuar në “b”**, për të siguruar përputhshmëri me standardet për dimensionim, prurje, presion dhe siguri hidraulike.

c. Ujësjellës-kanalizime urbane – rurale.

Argumentim:

- Territori i ndërhyrjes është pjesë e një zone zhvillimore në rritje (Porto Romano), ku duhet të **projektohen dhe integrohen linjat e ujësjellësit dhe kanalizimeve**, për t'u lidhur me rrjetin ekzistues ose të parashikuar sipas planeve zhvillimore vendore.
- Rrjetet duhet të **merren në dorëzim nga operatorët publikë të ujësjellës-kanalizimeve**, çka ligjërisht kërkon **projektim nga profesionist të licencuar në “c”**.
- Projektimi dhe miratimi i këtyre rrjeteve nga AKUM apo bashkia përkatëse **nuk pranohet pa firmë profesionale të licencuar në këtë kategori**.

d. Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) - damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.

Argumentim:

- Rruga hekurudhore dhe terminali ndodhen në një zonë të **ultësirës fushore të Porto Romanos**, me **nivel të lartë ujërash nëntokësorë**, rrezik përmbytjeje dhe shkarje të drenazhit.
- Mund të jenë të nevojshme:
 - **Tombino / priza uji**
 - **Kanale drenazhuese / devijime për ujërat e larta**
 - **Rrjedhë të kontrolluar të ujërave të sipërfaqes**
 - **Baraze dhe kaskada teknike** për disipimin e energjisë së rrjedhës
- Veprat si **damba, porta, kapërderdhëse** klasifikohen si **infrastrukturë hidroteknike** e rregulluar nga VKM 943 dhe kërkojnë projektim të **domosdoshëm nga profesionist i licencuar në “d”**.

6. PROJEKTUES RRUGE – HEKURUDHA

a. Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

Argumentim:

- Projekti përfshin aksesin rrugor për në terminalin hekurudhor dhe lidhjen me rrjetin rrugor ekzistues lokal dhe rajonal në zonën e Porto Romanos dhe Sukthit.
- Kërkohet projektim i rrugëve dytësore ndihmëse, hyrje-dalje për automjete, rrugica industriale të brendshme, për funksionimin logjistik dhe ndërlidhjen me rrjetin rrugor.
- Projektimi i rrugëve të këtij niveli përbën objekt të veprave të infrastrukturës rrugore, dhe mund të kryhet vetëm nga subjekte të licencuara në kategorinë “a” të projektimit rrugor, sipas VKM 943.
- Dimensionimi i seksioneve të rrugës, profili gjatësor, kthesat, rrjedhja e trafikut të rëndë dhe sinjalistika kërkojnë një projekt të veçantë teknik, të përgatitur nga një inxhinier rrugësh me licencë për këtë kategori.

e. Hekurudha - degëzime hekurudhore.

Argumentim:

- **Objekti kryesor i projektit është ndërtimi i një linje të re hekurudhore, e cila përfshin:**
 - Shtrimin e linjës
 - Degëzime teknike në terminal
 - Stacione dhe ndalesa
 - Vendkalime, trasa, mbikalime, nënshtresa balasteje, shina, traversa etj.
- Projekti parashikon ndërlidhjen e terminalit të Porto Romanos me linjën ekzistuese **Durrës – Tiranë – Rinas**, përmes një linje të re.
- **Projektimi i linjave hekurudhore, në çdo shtrirje dhe tipologji, kërkon patjetër licencim në kategorinë “e”, sipas VKM 943.** Kjo përfshin projektimin gjeometrik, konstruktiv dhe të të gjithë elementëve teknikë të linjës hekurudhore.
- Projekti për linjën hekurudhore duhet të përfshijë:
 - Trasimin
 - Profilin gjatësor
 - Seksionet standarde hekurudhore
 - Vendosjen e elementeve të sigurisë (sinjalistikë, ndërprerje emergjente, etj.)
 - Përgatitjen për sistemet elektrike dhe sinjalizimin e specializuar të trafikut hekurudhor

7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

a. Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.

Argumentim:

- Projekti i linjës hekurudhore përfshin elementë **të ndërhyrjes në terren dhe infrastrukturë mbështetëse**, si:
 - **Ura të vogla dhe tombino** për tejkalim të kanaleve kulluese ose për kalime teknike;
 - **Priza uji ose struktura inxhinierike me hapje <10 m**, të cilat kërkojnë projektim specifik strukturor dhe gjeoteknik.
- Sipas VKM 943, projektimi i këtyre strukturave **kërkon licencë specifike “a” për projektuesin e urave**, edhe në rastin kur ato janë pjesë e integruar në projekt rrugor ose hekurudhor.
- Urat e vogla dhe veprat e artit përbëjnë **element kyç për sigurinë hidraulike, qëndrueshmërinë e trupit rrugor dhe ruajtjen e fluksit natyror të ujërave**, ndaj kërkojnë **llogaritje specifike strukturore dhe kontroll të gjeometrisë dhe themelimit**.

d.Ura metalike.

Argumentim:

- Mundësia e përdorimit të **urave ose mbikalimeve metalike për linjën hekurudhore** është reale, për:
 - Kalim të linjës mbi rrugë ekzistuese ose pengesa natyrore
 - Ndërhyrje me struktura të montueshme me elementë metalikë për kalime teknike ose degëzime
- Elementë të tjerë që mund të kërkojnë strukturë metalike:
 - Platforma teknike për mirëmbajtje
 - Kalime të përkohshme ose struktura ndihmëse në fazën e ndërtimit
- Projektimi i **urave metalike** është një veprimtari e specializuar, që **nuk përfshihet në kategorinë e përgjithshme të projektimit konstruktiv**, por **vetëm në kategorinë “d” të licencës për projektuesin e urave dhe veprave arti**.
- Urat metalike kërkojnë projektim me standarde specifike për:
 - Lodhjen, zgjerimin termik, forcat dinamike
 - Përdorimin e elementëve të salduar ose të bulonuara sipas Eurocode 3 (EN 1993)
 - Trajtim kundër korrozionit, mirëmbajtje dhe përputhje me kodet hekurudhore/rrugore

8. PROJEKTUES GJEODET

a- Rivlime inxhinierike.

Argumentim:

- Projekti përfshin ndërtimin e një linje të re hekurudhore dhe stacionesh, gjë që kërkon:
 - Matje topografike të detajuara të terrenit ekzistues
 - Ndërtimin e rrjetit të pikave referuese gjeodezike
 - Trasimin e saktë të traseve, kthesave, lartësive, strukturave mbështetëse dhe elementeve infrastrukturorë
- Ky aktivitet hyn në fushën e rielimeve inxhinierike, që sipas VKM 943 kërkon licencë “a” për subjektin apo individin që e kryen.
- Pa rielime inxhinierike të sakta, asnjë element i projektit konstruktiv ose rrugor nuk mund të zhvillohet, miratohet apo zbatohet.

b- Rielime inxhinierike kadastrale.**Argumentim:**

- Zona e projektit përfshin tokë publike, industriale dhe ndoshta private, për të cilën:
 - Duhet të përcaktohen kufijtë ligjorë dhe teknikë të pronës
 - Të bëhen pasqyrimet e pasurive në terren
 - Të përgatiten materialet për legalizim, shpronësim, kalim pronësie apo akt-marrëveshje me institucionet publike (bashki, ALUIZNI, Kadastër)
- Ky aktivitet klasifikohet si rielim inxhinieriko-kadastral, dhe kërkon licencë “b”, sipas përcaktimeve të VKM 943.

e- Projektim fotogrametrik dhe hartografik.**Argumentim:**

- Për projektin e linjës hekurudhore, si dhe për qëllime dokumentimi dhe integrimi në GIS:
 - Kërkohet hartë topografike dhe ortofoto të zonës, për studim paraprak, miratim, planifikim dhe menaxhim pasuror.
 - Mund të përdoret dron me kamera me precizion të lartë për krijimin e modeleve 3D të terrenit dhe volumetrive
- Projektimi dhe përpunimi fotogrametrik i këtyre materialeve është veprimtari e licencuar në kategorinë “e”, dhe kërkon përdorim të teknologjive të certifikuar dhe softuerëve të specializuar.
- Rezultatet nga kjo fazë shërbejnë:
 - Si bazë për projektimin e infrastrukturës

- Për integrimin e projektit në sistemet digjitale të bashkive apo institucioneve të tjera
- Për monitorimin në kohë reale të progresit të punimeve në fazën e zbatimit

9. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

a- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate.

Argumentim:

- Projekti përfshin **ndërtimin e objekteve teknike, ndihmëse dhe operacionale përgjatë linjës hekurudhore**, përfshirë: Ndërtesa një- dhe dy-katëshe (stacione, kabina teknike, depo industriale, etj.)
- Këto objekte, për të garantuar sigurinë strukturore, kërkojnë **vlerësim të kapacitetit mbajtës dhe karakteristikave të themelimit të truallit**.
- Sipas VKM 943, çdo ndërhyrje ndërtimore mbi tokë për objekte civile deri në 5 kate, kërkon patjetër studim të tokës përmes licencës “a”.

d- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

Argumentim:

- Linja hekurudhore përshkon zona me reliev të ndryshueshëm, ku përfshihen:
 - Shpate natyrore ose artificiale,
 - Trase që kërkon gërmime, mbushje apo mbrojtje të skajeve me skarpitime.
- Ka rrezik për rrëshqitje ose deformim të terrenit, sidomos në zonat e Sukthit dhe Porto Romanos ku toka është e lirshme ose ujore.
- Projekti përfshin ndërtime në zona me qëndrueshmëri të ulët, prandaj kërkohet studim i posaçëm nga subjekt i licencuar në kategorinë “d”, për të garantuar sigurinë e infrastrukturës.
- Ky studim përcakton:
 - Qëndrueshmërinë e themelimit të shtratit hekurudhor
 - Nevojën për masa mbrojtëse, stabilizime me geosintetikë, mure mbajtëse, etj.

e- Studime e projekte hidrogjeologjike.

Argumentim:

- Projekti kalon në zona me:
 - **Nivele të larta ujërash nëntokësorë**
 - **Lumenj, kanale kullimi, terrene të përmytura sezonalisht**
- Është e nevojshme të vlerësohet:

- **Përhapja e ujërave nëntokësorë**
- **Rreziku i nëlagies dhe fundosjes së trupit të rrugës hekurudhore**
- **Ndikimi i ndërtimit në shtresat ujëmbajtëse dhe nevoja për drenazh ose mbrojtje ndaj ngritjes së ujërave**
- Sipas VKM 943, kjo veprimtari kërkon **licencë specifike “e” për projektim/studim hidrogeologjik.**

Individët apo personat juridik të cilët disponojnë licenca të cilat nuk janë në përputhje me pikat e Lidhjes 2 “Kategorite në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim”, të V.K.M. nr. 943, datë 28. 12. 2016, duhet të bëjnë rinovimin dhe ekuivalentimin e tyre. Në rastin e mosparaqitjes së licencave, ofertuesit nuk do të merren në konsideratë për kualifikim. Licencat duhet të jenë të paraqitura dhe të plotësohen nga licenca e subjektit si dhe të gjitha pikat e sipërpërmendura të cilat jepen edhe për individë duhet të përmbushen nga shumatorja e pikave të licencave individuale të stafit inxhinierik.

Pikat e licencave apo certifikimeve që nuk trajtohen në V.K.M. nr. 943, datë 28. 12. 2016 duhet të jenë në përputhje me V.K.M. Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat Dhe Lejet Që Trajtohen Nga Apo Nëpërmjet Qendrës Kombëtare Të Licencimit (Qkl) Dhe Disa Rregullime Të Tjera Nënligjore Të Përbashkëta”, Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, V.K.M. Nr. 407 date 19.06.2019 “Për Miratimin e Procedurës, to Kategorive, Kushteve, Kërkesave to Kualifikimit dhe te Eksperiencës Profesionale për Personin, te Cilit i Lëshohet Certifikata e Audituesit Energjetik” dhe akteve nënligjore në fuqi.

3.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prova të certifikimit nga organe të pavarura akredituese si më poshtë:

a) Çertifikatë ISO 9001:2015 të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësisë, dhe/ose të njëvlefshme me to që mund të garantojnë cilësinë e shërbimeve të kërkuara, objekt i tenderit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në

Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

– **Neni 45** – *Kriteret për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë:*

*“Autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të paraqesin **prova se disponojnë sisteme të përshtatshme të menaxhimit të cilësisë**, në përputhje me standarde europiane ose ndërkombëtare.”*

VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

– **Kreu IV, Neni 53, pika 1, shkronja “c”:**

“Autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të demonstrojnë **zbatimin e një sistemi të menaxhimit të cilësisë**, në përputhje me standardin ISO 9001 ose të barasvlershëm.”

Ne lidhje me projektin:

-Siguria dhe cilësia e projektimit

- ISO 9001:2015 siguron që subjektet që kryejnë projektimin:
 - Zbatojnë procedura të kontrolluara për kontrollin teknik, rishikimin dhe miratimin e dokumentacionit
 - Reduktojnë rrezikun e gabimeve inxhinierike dhe moskonformitetit
 - Sigurojnë gjurmueshmëri dhe auditueshmëri të gjithë procesit të projektimit

-Standard profesional i kërkuar për projekte infrastrukturore kombëtare dhe ndërkombëtare

- ISO 9001 është standard i rekomanduar për konsulentët dhe projektuesit në sektorë si transporti, energjia, ndërtimet dhe mjedisi – veçanërisht në projektet me rëndësi strategjike si ne rastin tone linjat hekurudhore.

-Kusht për pjesëmarrje në prokurim dhe vlefshmërinë kontraktore

- Subjektet pa sistem të certifikuar të cilësisë mund të skualifikohen nga procedurat e përzgjedhjes apo të konsiderohen të papërgatitura për projektet e ndërlikuara.
- Posedimi i ISO 9001:2015 është një garanci objektive që ata janë në gjendje të zbatojnë procedura të standardizuara sipas kërkesave të kontratës.

b) ISO 14001:2015 “Per sistemin e menaxhimit mjedisore” (te vlefshme) ose ekuivalent ne perputhje me objekt i tenderit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në

-Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar

- **Neni 5, pika 2:**

“Subjektet publike dhe private që ushtrojnë veprimtari me ndikim në mjedis, kanë për detyrë të **integrojnë parimet e mbrojtjes së mjedisit** në sistemet e tyre të menaxhimit dhe vendimmarrjes.”

- **Neni 25 – Vlerësimi i ndikimit në mjedis:**

“Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin jo vetëm përgatitjen e raportit, por edhe **përcaktimin e masave organizative dhe procedurave për menaxhimin e qëndrueshëm të ndikimeve mjedisore** gjatë fazës së projektimit dhe zbatimit.”

Kjo përfshin kërkesën për sisteme të organizuara dhe të verifikueshme të menaxhimit mjedisor.

-Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

- **Neni 45, pika 3:**

“Autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik të provojë se është **në gjendje të zbatojë masa mjedisore të barasvlershme me një sistem të menaxhimit mjedisor të njohur ndërkombëtarisht**, të tilla si ISO 14001.”

-VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

- **Kreu IV, Neni 54:**

“Operatorët ekonomikë mund të kërkohen të paraqesin **certifikata ose dëshmi për sisteme të menaxhimit mjedisor**, siç është standardi ISO 14001 ose ekuivalent.”

Ne lidhje me projektin:

-Natyra e projektit kërkon menaxhim të qëndrueshëm mjedisor

Projekti i linjes hekurdhore “Porto Romano – Sukth”:

- Ndërhyn në zonë industrialo-portuale, afër lagunave dhe ekosistemeve të ndjeshme.
- Përfshin punime inxhinierike që ndikojnë në tokën, ujin, ajrin dhe biodiversitetin.
- Përfshin detyrimin për të hartuar Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) dhe Planin e Menaxhimit Mjedisor.

ISO 14001:2015 është standardi ndërkombëtar për organizimin dhe monitorimin e detyrave mjedisore gjatë projektimit dhe zbatimit të projekteve.

-Siguron që subjekti projektues ka kapacitete të strukturuar për të:

- Identifikuar, minimizuar dhe parandaluar ndikimet në mjedis
- Integruar masat mjedisore në fazën e projektimit
- Menaxhuar mbeturinat, ndotjen akustike, mbrojtjen e peizazhit dhe ndotjen e ujërave
- Dokumentuar dhe gjurmuar përputhshmërinë ligjore

-Kriter për projekte publike, ndërkombëtare dhe të financuara nga donatorë

- EIB, WBIF, BERZH dhe BE **kërkojnë ISO 14001 ose ekuivalent** për subjektet kontraktuese të angazhuara në projekte që kanë ndikim të ndjeshëm mjedisor.
- Është kusht për **kualifikimin** në shumë procedura konkurruese të nivelit të lartë.

c) **ISO 50001:2015 “Per sistemin e menaxhimit të energjisë” (te vlefshme) ose ekuivalent ne perputhje me objektin e kontrates.** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në

-Ligji Nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë”

- **Neni 5, pika 1:**

“Personat fizikë dhe juridikë që projektojnë, ndërtojnë ose operojnë objekte që konsumojnë energji, duhet të respektojnë **parimet e efikasitetit të energjisë**, duke zbatuar praktika të njohura ndërkombëtare për menaxhimin energjetik.”

- **Neni 12, pika 3:**

“Subjektet që realizojnë projekte publike ose me ndikim të konsiderueshëm energjetik, **inkurajohen të aplikojnë sisteme të menaxhimit të energjisë** në përputhje me standardet ndërkombëtare.”

Ne lidhje me projektin:

-Projekti përfshin sisteme me konsum të lartë energjie:

- Elektrifikimi i linjës hekurudhore
- Sistemi i sinjalizimit dhe telekomunikimit
- Ndriçimi i platformave dhe stacioneve
- Stacione teknike për operim dhe kontroll

Këto sisteme krijojnë kosto të konsiderueshme operative energjie, të cilat duhen projektuar që në fazën teknike për të qenë efikase dhe të qëndrueshme.

-ISO 50001 siguron që projektuesi:

- Harton zgjidhje që **optimizojnë konsumin e energjisë** gjatë gjithë jetës së objektit
- Zbaton **metodologji për analiza të performancës energjetike**
- Përdor standarde ndërkombëtare për llogaritjen dhe menaxhimin e **indikatoreve të efikasitetit energjetik**.

-Vlera e shtuar në projektet e financuara nga donatorë (BE, EIB, WBIF)

ISO 50001 është një nga standardet e përfshira në kriteret ESG (Environmental, Social, Governance) të donatorëve ndërkombëtarë

Përfshirja e tij rrit besueshmërinë dhe përputhshmërinë me politikat e gjelbra të BE-së, sidomos në projektet që lidhen me transportin e gjelbër dhe tranzicionin energjetik

4. Stafi i kërkuar :

Operatori ekonomik ose bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të ketë të përfshirë si drejtues teknik dhe të figurojë në Licensën e shoqërisë, stafin e mëposhtëm:

- | | |
|-----------------------------|---------|
| - Projektues Arkitekt | 1 (një) |
| - Projektues Konstruktor | 1 (një) |
| - Projektues Infrastruktura | 1 (një) |
| - Projektues Mekanik | 1 (një) |
| - Projektues Elektrik | 1 (një) |
| - Projektues Gjeodet | 1 (një) |
| - Projektues Gjeolog | 1 (një) |

- Projektues Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Ndertimi Preventivues 1 (një)

Për stafin e mësipërm duhet paraqitur për secilin dokumentacioni provues si:

- Diploma
- CV personale
- Kontrata e Punës (e vlefshme ligjërish)
- Secili nga anëtarët e stafit të sipërcituar dhe të angazhuar, të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve për t'u realizuar objekt i kësaj kontratë në rast të shpalljes fitues.
- Stafi i sipërcituar të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentim:Baza ligjore

- Ligji nr. 107/2014, i ndryshuar me Ligjin nr. 119/2020, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 8402/1998, i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”;
- VKM nr. 943, datë 28.12.2016, për kriteret dhe procedurat e licencimit të profesionistëve në fushën e zhvillimit të territorit;
- Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 45, pika 1, shkronja “a”, kërkon që operatorët të demonstrojnë kapacitet teknik dhe profesional të mjaftueshëm.

Në projektet e infrastrukturës hekurudhore si “Linja Hekurudhore Porto Romano – Sukth”, që përfshin:

- Ndërtime sipërfaqësore dhe nëntokësore
- Struktura betoni, metalike dhe ndihmëse
- Impiante elektrike, mekanike, ndriçimi, ujësjellës-kanalizime, drenazhime, etj.
- Studime të specializuara gjeologjike, gjeodezike, hidroteknike

... është detyrimisht e nevojshme që projekti të hartohet nga një staf i plotë multidisiplinar, me përfaqësim profesional nga çdo fushë.

Profili i kërkuar	Arsyeja teknike
Projektues Arkitekt	Për konceptimin arkitektonik të strukturave ndihmëse, ambienteve teknike, terminaleve, etj.
Projektues Konstruktor	Për llogaritjen e sigurisë strukturore të objekteve dhe veprave arti

Profili i kërkuar	Arsyeja teknike
Projektues Infrastruktura (rrugë/hekurudhë)	Për projektimin planimetrik, profilin gjatësor e tërthor, kros-seksionet, trupin e rrugës
Projektues Mekanik	Për impiantet termoteknike, kondicionimin dhe sistemet e zjarrit
Projektues Elektrik	Për rrjetin elektrik të objekteve dhe ndriçimin rrugor
Projektues Gjeodet	Për matje, trasim dhe hartografi teknike
Projektues Gjeolog	Për studime të tokës, kapacitet mbajtës dhe shpate
Projektues Hidroteknik	Për projektimin e kanalizimeve, ujësjellësit, sistemeve të kullimit e mbrojtjes nga ujërat
Inxhinier Ndërtimi Preventivues	Për hartimin e preventivave, përlllogaritjen e sasisë dhe kostos së materialeve

Perfshirja e stafit ne listë pagesat e operatorit

- Garancia e përfshirjes reale në staf – Shumë operatorë shpesh paraqesin CV fiktive. Detyrimi për të qenë në licencë + listë pagesash për të paktën 3 muaj garanton se personi është realisht i brendshëm dhe i angazhuar me përgjegjësi në projekt.
- Drejtuesi teknik është kërkuar nga vetë VKM 943 si detyrim për të ligjësuar përgjegjësinë teknike të subjektit.
- Në mungesë të stafit të brendshëm të përfshirë dhe të licencuar, projekti rrezikon mungesë cilësie, bashkërendimi teknik dhe siguri.

Pse kërkohen dokumentet shoqëruese

Diploma + CV	Verifikimi i kualifikimeve dhe eksperiencës së kërkuar
Kontratë pune e vlefshme ligjore	Siguron se personi është i punësuar realisht dhe me detyrime
Deklaratë disponueshmërie angazhime të tjera	Shmang përfshirjen e personelit të mbingarkuar ose me
Listë pagesash 3 mujore	Provon se personi është pjesë aktive e shoqërisë dhe jo i ftuar vetëm për aplikim

5. Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave (e Vërtetuar kjo me listë pagesat përkatëse, të Konfirmuar nga Drejtoria e Taimeve, sipas formularit E-Sig 02/a,)

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentimi: Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

6.Operatori Ekonomik duhet të këtë në stafin e tij si drejtues teknik një nga inxhinierët e kërkuar më sipër të specializuar për projektimin sizmik të strukturave, vërtetuar kjo me diplomën përkatëse dhe të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentim: Ky kriter është në përputhje me

Ligji Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”; Përditësuar me Ligjin Nr. 119/2020, datë 7.10.2020

- **Neni 45 (i ndryshuar me nenin 22 të Ligjit Nr. 119/2020):**

“Dokumentacioni teknik për zhvillimin dhe ndërtimin duhet të hartohet nga specialistë të licencuar dhe të pajisur me certifikata përkatëse të njohura nga institucionet kompetente.”

“Në rastin e veprave që përfshijnë struktura mbajtëse, **projekti strukturor dhe ai sizmik** hartohen dhe firmosen nga specialistë me **kualifikim të veçantë** në inxhinieri strukturore dhe sizmike.”

- **Shtesë e rëndësishme (neni 3, pika 15/1):**

“Në veprat me karakter të veçantë (p.sh. objekte infrastrukturore, vepra arti, objekte industriale të mëdha), **drejtuesi teknik duhet të jetë i specializuar** në fushën përkatëse të ndërtimit ose projektimit.”

-Ligji Nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”; Përditësuar me Ligjin Nr. 120/2020, datë 7.10.2020

- **Neni 11, pika 3 (ndryshuar):**

“Subjekti që kryen projektimin e objekteve ose veprave publike duhet të ketë një **drejtues teknik me përgatitje të lartë profesionale** dhe me **eksperiencë të dokumentuar** në projektimin dhe/ose mbikëqyrjen e tyre, i cili mban përgjegjësi për përmbajtjen teknike të dokumentacionit të projektit.”

- **Neni 12/1 (i shtuar):**

“Për objektet që ndodhen në **zona me rrezik sizmik**, llogaritjet strukturore dhe zgjidhjet teknike **duhet të miratohen nga një specialist i certifikuar për projektim sizmik** sipas kërkesave të Eurokodeve.”

-VKM Nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së zhvillimit të territorit”:

- **Neni 14 & Aneksi Teknik:**

Kërkon **projekt sizmik të miratuar dhe nënshkruar nga specialist strukture me njohuri të avancuara në projektimin për tërmete**, sipas zonave sizmike të përcaktuara për Shqipërinë.

Ne lidhje me projektin:

Zona e projektit është me rrezik sizmik të lartë

- Porto Romano–Sukth ndodhet në zonën sizmike II (sipas hartës sizmike shqiptare), me përshpejtim të projektimit $a_0 \geq 0.25g$, e cila kërkon llogaritje të avancuar dinamike dhe masa mbrojtëse.

b) Strukturat kritike që përfshihen në projekt:

- **Trase hekurudhore mbi trup artificial**, me mbushje
- **Ura dhe tombino**, me ngarkesa dinamike nga trenat
- **Stacione**, platforma dhe ndërtesa teknike për sinjalizim/telekomunikim
- **Mbikalime/nënkalime** dhe struktura ndihmëse

Të gjitha këto duhet të **projektuar për të përballuar ngarkesat e tërmeteve**, me metoda që aplikojnë analizën spektrale ose metoda të përshpejtimit të përgjigjes (response spectrum analysis).

c) Drejtuesi teknik garanton përputhshmëri me ligjin dhe standardet

- Është personi që **firmos projektin**, përfshirë llogaritjet sizmike.
- Mbart **përgjegjësi ligjore** për sigurinë e strukturës dhe përputhjen me Eurocodet, ligjin shqiptar dhe kërkesat e lejes ndërtimore.

7.Ekspert Mjedisor të certifikuar nga Ministria e Mjedisit, si ekspertë të VNM-së dhe auditimit mjedisor, vërtetuar kjo me certifikimin përkatës dhe të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentim: Ky kriter është në përputhje me

-Ligjin Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (i ndryshuar)

Ky ligj është dokumenti themelor për procesin e VNM-së në Shqipëri dhe parashikon:

Neni 6: “Subjekti që kërkon miratimin mjedisor duhet të sigurojë përgatitjen e raportit të VNM-së nga një ekspert i licencuar.”

Neni 8, pika 3: “Raporti i VNM-së përgatitet nga eksperti mjedisor i licencuar ose nga një grup pune që përfshin ekspertë të specializuar.”

-Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 247, datë 30.4.2014, “Për përcaktimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për licencimin e ekspertëve të VNM-së dhe miratimin e strukturës dhe përmbajtjes së raportit të VNM-së”

Kjo VKM thekson: Neni 5, pika 1: “Raporti i VNM-së përgatitet vetëm nga ekspertë të licencuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.”

Për çdo projekt që i nënshtrohet procedurës së VNM-së paraprake ose të thelluar, hartimi i dokumentit të VNM-së është detyrim ligjor. Ky dokument **nuk mund të hartohet nga stafi i zakonshëm projektues (inxhinierë, arkitektë, ekonomistë)** në mungesë të **një eksperti mjedisor të licencuar**, pasi:

- Ky ekspert garanton **besueshmërinë dhe përputhshmërinë me legjislacionin mjedisor** kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Përfaqëson një komponent **të pavarur dhe teknik**, të domosdoshëm për vlerësimin e ndikimeve në ajër, ujë, tokë, biodiversitet, burime natyrore, shëndet të njerëzve etj.

Përfshirja që në fazat fillestare siguron që:

- **Ndikimet mjedisore identifikohen dhe shmangen ose minimizohen** përmes alternativave të projektit.
- Këshillat dhe vërtetimet e ekspertit mjedisor ndikojnë drejtpërdrejt në **zgjedhjen e vendndodhjes, teknologjisë, rrjedhës së punimeve**, çka përmirëson cilësinë dhe pranueshmërinë e projektit.

Raporti i VNM-së publikohet dhe shqyrtohet nga autoritetet dhe publiku. Nëse hartohet nga një ekspert i njohur dhe i pavarur, ai ka më shumë peshë në procesin e konsultimit publik dhe në marrjen e lejes mjedisore.

Ne lidhje me projektin:

- Seksioni 4.3 i ToR kërkon:

“Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS), në përputhje me kuadrin ligjor mjedisor...”

- Konsulenti është i detyruar të hartojë:
 - VNMS
 - **Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit (SEP)**
 - **Plani i Veprimit për Zhvendosjen (RAP)**
 - **NTS – Përmbledhja jo-teknike**
 - **Plani për Risistemimin (PVZH)**
 Këto janë të gjitha **komponente të një procesi të thelluar VNM** sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

8. Ekspert Zjarrfikës Privat, i certifikuar për ushtrimin e profesionit “Ekspert Zjarrfikës Privat” nga MNZSH (MZSH), vërtetuar kjo me certifikimin përkatës dhe të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Argumentim: Ky kriter është në përputhje me:

-Ligji Nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”, i ndryshuar:

- **Neni 17 – “Projektimi dhe ndërtimi i objekteve”:**

“Në çdo projekt ndërtimi apo infrastrukturë, duhet të jenë të përfshira masat për mbrojtje nga zjarri dhe shpëtimi, të hartuara nga persona fizikë apo juridikë të licencuar nga Ministria e Brendshme.”

- **Neni 19 – “Detyrimet e subjekteve që hartojnë dhe zbatojnë projektet”:**

“Personat fizikë apo juridikë që hartojnë projektet e objekteve janë të detyruar të përfshijnë masat teknike për mbrojtje nga zjarri në përputhje me normat dhe standardet përkatëse.”

-Urdhri i Ministrit të Brendshëm Nr. 1421, datë 13.12.2017, për miratimin e Rregullores Teknike për Mbrojtjen nga Zjarri në Ndërtime dhe Infrastruktura

- Përcakton në mënyrë të qartë se **çdo projekt ndërtimi, përfshirë infrastrukturën hekurudhore**, duhet të përmbajë:
 - Planin e evakuimit
 - Zgjidhjet konstruktive për mbrojtje nga zjarri
 - Sistemet për zbulimin, sinjalizimin dhe shuarjen e zjarrit
 - Zgjidhje për qasjen e mjeteve zjarrfikëse dhe rrugët emergjente
- **Këto elementë janë të detyrueshme të hartohen nga një Ekspert Zjarrfikës Privat i certifikuar nga MZSH, në përputhje me procedurën e licencimit dhe rregullat profesionale.**

-Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar

- **Neni 45, pika 3:** Dokumentacioni teknik për marrjen e lejes së ndërtimit duhet të përfshijë zgjidhjet e sigurisë në rast zjarri, të vlerësuara nga ekspertët përkatës.

-Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”

- **Kërkon në mënyrë të detyrueshme** që për çdo projekt ndërtimi që dorëzohet në e-leje, duhet të ketë **vlerësim dhe akt teknik për mbrojtjen nga zjarri**, të përgatitur nga ekspertë të licencuar.

Ne lidhje me projektin:

a) Linja hekurudhore përbën objekt me rrezik të shtuar zjarri

- Për shkak të kalimit të trenave me mallra të rrezikshme, hidrokarbure, karburante, qymyr etj.
- Prezencës së instalimeve elektrike dhe pajisjeve të sinjalizimit/telekomunikimit
- Afërsisë me struktura portuale, industriale dhe logjistike

b) Eksperti Zjarrfikës përcakton zgjidhjet teknike në projekt

- Sistemet për zbulimin dhe shuarjen e zjarrit
- Rrugët e qasjes së mjeteve zjarrfikëse
- Standardet e materialeve ndërtimore kundër zjarrit
- Planin e evakuimit dhe ndërhyrjes në rast emergjence

c) Pa ekspertizë zjarrfikëse nuk mund të merret leje ndërtimi

- Projektet pa aktin e vlerësimit nga Eksperti Zjarrfikës Privat nuk pranohen nga portali **e-leje**, sipas praktikës ligjore dhe vendimeve të ONM-së për ndërtim.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqip ose anglisht si dhe në rastin e dokumenteve të lëshuara nga autoritete publikë, t'i certifikojnë ato me vulën "Apostille". Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Per vetedeklaratat e paraqitura nga nga ofertuesit e huaj duhet te kryhet vertetimi i firmes para nje noteri dhe certifikimi me vulen apostile. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për shërbimet e kërkuara duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Në përcaktimin e specifikimeve teknike janë vendosur në përputhje me nevojat e institucionit për të garantuar funksionimin dhe arritjen e qellimeve të përcaktuara.

Për sa më sipër, specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme e saktë e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

Arsyetimi për mos ndarjen e kontratës në lote.

Nëse projekti ndahet në lote të ndryshme dhe këto i jepen projektuesve të ndryshëm, rrezikohet që të ketë **mospërputhje teknike** mes llojeve të projekteve (p.sh. arkitektura, struktura, instalime elektrike e hidraulike).

Një projektues i vetëm mund të sigurojë:

- **Një koordinim më të mirë ndërdisiplinor**
- **Zvogëlim i kostove administrative dhe procedural. Ndarja në lote do të thotë:**
 - Procedura të veçanta tenderimi për secilin lot.
 - Mbikëqyrje dhe menaxhim i veçantë për secilin kontraktues.
 - Rritje e kostove të menaxhimit dhe dokumentacionit.
- **Përgjegjësi e qartë ligjore dhe teknike**

Një projektues unik ka përgjegjësi të plotë për gjithë dokumentacionin dhe përputhshmërinë mes pjesëve të projektit. Nëse projekti ndahet në shumë lote:

- Është e vështirë të përcaktohet se kush mban përgjegjësi në rast problemi.
- Mund të ndodhin mbivendosje kompetencash ose boshllëqe në dokumentacion.

Kontrata e projektimit nuk duhet ndarë në lote nëse projekti mund të realizohet në mënyrë të efektshme dhe të koordinuar nga një subjekt i vetëm projektues.

